




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, ee.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 39.1 pika (k) të Statutit të Komunës së Gjilanit Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur më 15.07.2011, miratoi këtë:

V E N D I M

I

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit i **PROPOZON** Presidencës së Republikës së Kosovës që: për merita në ruajtjen e substancës etnike shqiptare të Kosovës e të viseve shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia Versajiste dhe Avnojiste, **Mulla Idriz Gjilani** të laureohet me Medaljen më të lartë të Republikës së Kosovës.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Propozimi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit që Mulla Idriz Gjilani të laureohet me Medaljen më të lartë të Republikës të Kosovës nga Presidenca e Republikës së Kosovës.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16/17856
Gjilan më 15.04/2011

Kuvendi i komunës,

Izmi Zeka, Kryesues